VENDIM
Nr. 6, datë 30.9.2011

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të përbëra nga:

Shpresa Beçaj	kryesuese
Gani Dizdari	anëtar
Ardian Dvorani	anëtar
Besnik Imeraj	anëtar
Fatos Lulo	anëtar
Ardian Nuni	anëtar
Arjana Fullani	anëtare
Majlinda Andrea	anëtare
Guxim Zenelaj	anëtar
Aleksandër Muskaj	anëtar
Andi Çeliku	anëtar
Evelina Qirjako	anëtare
Mirela Fana	anëtare
Medi Bici	anëtar,

me pjesëmarrjen e sekretares gjyqësore Anisa Take, sot në datën 30.9.2011 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore penale çështjen penale që u përket:

TË PANDEHURVE: Arlind Hyseni, i biri i Qamilit dhe i Fiqiretes, i datëlindjes 16.6.1985, lindur në Pukë dhe banues në Tiranë, me kombësi dhe shtetësi shqiptare, i dënuar më parë, hetuar dhe gjykuar në mungesë.

Florian Muça, i biri i Kaloshit dhe i Rakibes, i vitlindjes 1984, lindur në Dibër dhe banues në Tiranë, rr. "Besa", shtëpi private pa numër, me arsim 8-vjeçar, i padënuar më parë, hetuar dhe gjykuar me masë sigurimi arrest në burg, mbrojtur në gjyq nga av. Ferdinand Doja.

AKUZUAR: Për veprat penale të vjedhjes me pasojë vdekjen e kryer në bashkëpunim, vjedhjes me dhunë e kryer në bashkëpunim dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake, të parashikuara nga nenet 141-25, 139-25 dhe 278/4 të Kodit Penal.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 641, datë 2.6.2005, ka vendosur:

Deklarimin fajtor të të pandehurit Arlind Hyseni për veprën penale të vjedhjes me pasojë vdekjen e shtetasit Genci Sade, e kryer në bashkëpunim dhe në bazë të nenit 141-25 të Kodit Penal dënimin e tij me burgim të përjetshëm.

Ndryshimin e cilësimit ligjor të veprës penale të kryer nga i pandehuri Arlind Hyseni në dëm të shtetasit Myrteza Sade nga vjedhje me dhunë në bashkëpunim, parashikuar nga neni 139-25 të Kodit Penal në vjedhje me pasojë vdekjen, e kryer në bashkëpunim dhe e mbetur në tentativë dhe, në bazë të nenit 141-25-22 të Kodit Penal, dënimin e tij me 20 vjet burgim.

Ndryshimin e cilësimit ligjor të veprës penale të kryer nga i pandehuri Arlind Hyseni në dëm të shtetases Hatixhe Sade nga vjedhje me dhunë në bashkëpunim, parashikuar nga neni 139-25 të Kodit Penal, në vjedhje me pasojë vdekjen, e kryer në bashkëpunim e mbetur në tentativë dhe, në bazë të nenit 141-25-22 të Kodit Penal, dënimin e tij me 15 vjet burgim.

Deklarimin fajtor të të pandehurit Arlind Hyseni për veprën penale të mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe, në bazë të nenit 278/4 të Kodit Penal, dënimin me 10 vjet burgim.

Në bashkim të dënimeve në bazë të nenit 55 të Kodit Penal, dënimin e të pandehurit Arlind Hyseni me burgim të përjetshëm.

Si pasojë e gjykimit të shkurtuar, në zbatim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, dënimin përfundimisht të pandehurit Arlind Hyseni me 25 vjet burgim.

Vuajtja e dënimit për të pandehurin Arlind Hyseni fillon nga dita e ekzekutimit të këtij vendimi nga policia gjyqësore.

Deklarimin fajtor të pandehurit Florian Muça për veprën penale të vjedhjes me pasojë vdekjen e shtetasit Genci Sade, e kryer në bashkëpunim dhe në bazë të nenit 141-25 të Kodit Penal dënimin e tij me burgim të përjetshëm.

Ndryshimin e cilësimit ligjor të veprës penale të kryer nga i pandehuri Florian Muça në dëm të shtetasit Myrteza Sade nga vjedhje me dhunë në bashkëpunim, parashikuar nga neni 139-25 të Kodit Penal, në vjedhje me pasojë vdekjen e kryer në bashkëpunim e mbetur në tentativë dhe, në bazë të nenit 141-25-22 të Kodit Penal, dënimin e tij me 20 vjet burgim.

Ndryshimin e cilësimit ligjor të veprës penale të kryer nga i pandehuri Florian Muça në dëm të shtetases Hatixhe Sade nga vjedhje me dhunë në bashkëpunim, parashikuar nga neni 139-25 të Kodit Penal në vjedhje me pasojë vdekjen e kryer në bashkëpunim, e mbetur në tentativë dhe, në bazë të nenit 141-25-22 të Kodit Penal, dënimin e tij me 15 vjet burgim.

Deklarimin fajtor të pandehurit Florian Muça për veprën penale të mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe, në bazë të nenit 278/4 të Kodit Penal, dënimin me 10 vjet burgim.

Në bashkim të dënimeve, në bazë të nenit 55 të Kodit Penal, dënimin e të pandehurit Florian Muça me burgim të përjetshëm.

Si pasojë e gjykimit të shkurtuar në zbatim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, dënimin përfundimisht të të pandehurit Florian Muça me 25 vjet burgim.

Vuajtja e dënimit të të pandehurit Florian Muça fillon nga dita e arrestimit në flagrancë.

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 65, datë 1.2.2006, ka vendosur:

Prishjen e vendimit nr. 641, datë 2.6.2005 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim po asaj gjykate, por me tjetër trup gjykues.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 612, datë 3.10.2007, ka vendosur:

Prishjen e vendimit nr. 65, datë 1.2.2006 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe kthimin e akteve për rishqyrtim në po atë gjykatë, por me tjetër trup gjykues.

Gjykata e Apelit Tiranë, pas rigjykimit të çështjes, me vendimin nr. 312, datë 16.5.2008, ka vendosur:

Lënien në fuqi të vendimit nr. 641, datë 2.6.2005 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Kundër vendimit nr. 312, datë 16.5.2008 të Gjykatës së Apelit Tiranë ka paraqitur rekurs i gjykuari Florian Muça, nëpërmjet mbrojtësve të tij Ferdinand Doja dhe Klojda Dashi, të cilët kërkojnë:

Prishjen e vendimit nr. 312, datë 16.5.2008 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në po atë gjykatë.

Shkaqet që paraqet në rekurs i gjykuari Florian Muça për prishjen e vendimit të gjykatës së apelit janë:

- Gjykata e shkallës së parë me të drejtë bëri ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale për sa u përket pasojave të ardhura te të dëmtuarit Myrteza dhe Hatixhe Sade, por ajo përsëri gaboi, sepse mendimi kriminal është një, pasi nga ana subjektive të pandehurit janë marrë vesh që të vidhnin këtë banesë.

- Vepra penale e vjedhjes me pasojë vdekjen kërkon se kur gjatë kryerjes së vjedhjes, edhe kur nga dhuna e ushtruar kanë ardhur si pasojë vdekja e një ose më shumë personave, apo vdekja e një personi dhe dëmtimi i të tjerëve, përsëri do të kishim vetëm një akuzë, atë të parashikuar nga neni 141 i Kodit Penal.

- Gjykata në rastin konkret mund të kishte ngritur akuzën e vjedhjes me pasojë vdekjen e shtetasit Genci Sade dhe plagosjes së dy personave të tjerë.

- Gjykata e shkallës së parë dhe ajo e apelit kanë gabuar, pasi vepra penale e vjedhjes me pasojë vdekjen, parashikuar nga neni 141 i Kodit Penal nuk është konsumuar plotësisht, por ajo ka mbetur në fazën e tentativës, e parashikuar nga neni 141-22 të Kodit Penal.

- Ndërmjet autorëve të veprës penale ka ekzistuar marrëveshja për të kryer vjedhje me anë të dhunës, por nuk ka ekzistuar marrëveshja që ato të kryenin vjedhje me pasojë vdekjen, prandaj është e qartë

se ndodhemi përpara eksesit të ekzekutorit.

- Ne kemi mbajtur qëndrim pohues që në fillim të procedimit penal, pasi kemi shpjeguar gjithçka mbi mekanizmin e ngjarjes, duke treguar pendesë, prandaj gjykatat duhet ta kishin parasysh këtë fakt dhe të bënin diferencimin në caktimin e masave të dënimit për dy të pandehurit, pasi nuk mund të barazohet një i pandehur që i fshihet drejtësisë me një tjetër që ka treguar pendesë të thellë.

Kundër vendimit nr. 312, datë 16.5.2008 të Gjykatës së Apelit Tiranë ka paraqitur rekurs i gjykuari Arlind Hyseni nëpërmjet mbrojtësit të tij Laert Rexho, i cili kërkon:

Prishjen e vendimit nr. 312, datë 16.5.2008 të Gjykatës së Apelit Tiranë, duke i caktuar të gjykuarit një masë më të butë dënimi.

Shkaqet që paraqet në rekurs i gjykuari Arlind Hyseni për prishjen e vendimit të gjykatës së apelit janë:

- Ne kemi pasur si qëllim vjedhjen e banesës së shtetasit Myrteza Sade dhe jo dëmtimin e familjarëve që jetonin në atë banesë.

- Vepra penale pavarësisht nga vullneti i të gjykuarve nuk është kryer, por ka mbetur në fazën e tentativës, prandaj këtë fakt duhet ta merrnin parasysh prokuroria në ndërtimin e akuzës dhe gjykata në dhënien e vendimit.

- Nga i gjykuari është kërkuar gjykim i shkurtuar dhe megjithëse gjykata ka zbatuar nenin 406 të Kodit të Procedurës Penale, ajo ka dhënë një dënim në maksimumin e tij, çka nuk i përgjigjet rrethanave lehtësuese që kanë qenë prezent.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin e datës 23.6.2010, ka vendosur:

Kalimin e çështjes në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë për unifikimin e praktikës gjyqësore lidhur me interpretimin e nenit 141 të Kodit Penal.

Kolegji Penal shtron për zgjidhje përpara Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë çështjet e mëposhtme:

1. Në rastin e akuzave për krimin e vjedhjes me pasojë vdekje, të parashikuar nga neni 141 i Kodit Penal, kur si pasojë ka ardhur vdekja e personit, por nuk është shtënë në dorë (vjedhur) pasuria e tij, vepra penale do të konsiderohet e konsumuar apo e mbetur në tentativë?

2. Në rastet e akuzave për krimin e vjedhjes me pasojë vdekje, të parashikuar nga neni 141 i Kodit Penal, kur si pasojë ka ardhur vdekja e një personi dhe plagosja (e lehtë apo e rëndë) e një apo disa personave, a kemi konkurrim me nenin 141 të Kodit Penal të veprave të tjera, si: vjedhje me dhunë, vjedhje me armë, plagosje e rëndë, plagosje e lehtë?

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË,

Pasi dëgjuan relatimin e çështjes nga gjyqtarët Andi Çeliku dhe Majlinda Andrea; prokurorin pranë Prokurorisë së Përgjithshme, Artur Selmani, që kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 312, datë 16.5.2008 të Gjykatës së Apelit Tiranë lidhur me kualifikimin e veprave penale si më poshtë:

Deklarimin fajtor të të pandehurit Arlind Hyseni për veprën penale të vrasjes me dashje në dëm të shtetasit Genci Sade, parashikuar nga neni 79/ë të Kodit Penal dhe dënimin e tij me burgim të përjetshëm.

Deklarimin fajtor të të pandehurit Arlind Hyseni për veprën penale të vjedhjes me armë të kryer në bashkëpunim, e mbetur në tentativë në dëm të shtetasit Myrteza Sade dhe, në bazë të neneve 141-22-25 të Kodit Penal, dënimin e tij me 20 vjet burgim.

Deklarimin fajtor të të pandehurit Arlind Hyseni për veprën penale të plagosjes rëndë me dashje në dëm të shtetasit Myrteza Sade dhe, në bazë të nenit 88/1 të Kodit Penal, dënimin e tij me 6 vjet burgim.

Deklarimin fajtor të të pandehurit Arlind Hyseni për veprën penale të vjedhjes me armë, e mbetur në tentativë, në dëm të shtetases Hatixhe Sade dhe dënimin e tij me 20 vjet burgim.

Deklarimin fajtor të të pandehurit Arlind Hyseni për veprën penale të mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe, në bazë të nenit 278/4 të Kodit Penal dënimin e tij me 10 vjet burgim.

Në bashkim të këtyre dënimeve, bazuar në nenin 55 të Kodit Penal, dënimin e tij me një dënim të vetëm, me burgim të përjetshëm.

Me aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale dënimin e tij me 25 vjet burgim.

Deklarimin fajtor të të pandehurit Florian Muça për veprën penale të vjedhjes me pasojë vdekjen, e kryer në bashkëpunim, e mbetur në tentativë në dëm të shtetasit Genci Sade dhe, në bazë të nenit 141-22-25 të Kodit Penal, dënimin e tij me burgim të përjetshëm.

Deklarimin fajtor të të pandehurit Florian Muça për veprën penale të vjedhjes me armë, e mbetur në tentativë, e kryer në bashkëpunim në dëm të shtetasit Myrteza Sade dhe, në bazë të nenit 140-22-25 të Kodit Penal, dënimin e tij me 20 vjet burgim.

Deklarimin fajtor të të pandehurit Florian Muça për veprën penale të vjedhjes me armë të kryer në bashkëpunim e mbetur në tentativë në dëm të shtetases Hatixhe Sade, parashikuar nga neni 140-22-25 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me 20 vjet burgim.

Deklarimin fajtor të të pandehurit Florian Muça për veprën penale të mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe, në bazë të nenit 278/2 të Kodit Penal, dënimin e tij me 4 vjet burgim.

Në bashkim të dënimeve, në bazë të nenit 55 të Kodit Penal, dënimin e të pandehurit me burgim të përjetshëm.

Në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale dënimin e të pandehurit Florian Muça me 25 vjet burgim.

Dëgjuan mbrojtësin e të gjykuarit Florian Muça, av. Ferdinand Doja, i cili, në bazë të nenit 441/b të Kodit të Procedurës Penale, kërkoi ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë dhe të Gjykatës së Apelit Tiranë, për sa i përket cilësimit ligjor të veprës penale dhe masës së dënimit me të cilën është dënuar i gjykuari Florian Muça, në përfundim,

VËREJNË:

Në Gjykatën e Lartë në datën 24.6.2008 është regjistruar çështja penale nr. 53109-00526-00-2008 regj. them., që u përket të gjykuarve Arlind Hyseni dhe Florian Muça, të akuzuar për veprat penale të vjedhjes me pasojë vdekjen e kryer në bashkëpunim, vjedhjes me dhunë e kryer në bashkëpunim dhe të mbajtjes pa leje të armëve luftarake, të parashikuara nga nenet 141-25, 139-25 dhe 278/4 të Kodit Penal.

Vendimi nr. 312, datë 16.5.2008 i Gjykatës së Apelit Tiranë, me të cilin është lënë në fuqi vendimi nr. 641, datë 2.6.2005 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është marrë në zbatim të keq të ligjit material penal, prandaj vendimet e gjykatave duhet të ndryshohen, për sa i përket cilësimit juridik të veprave penale të kryera nga të gjykuarit.

Nga gjykimi i çështjes në gjykatat e të gjitha shkallëve, deri në këtë fazë të gjykimit rezultojnë të provuara faktet dhe rrethanat e mëposhtme:

Të gjykuarit Arlind Hyseni dhe Florian Muça janë banorë të qytetit të Tiranës dhe kanë pasur njohje të mëparshme me njëri-tjetrin.

Në datën 12.7.2004 rreth orës 01:45 të gjykuarit, pasi janë marrë vesh më parë me njëri-tjetrin, kanë shkuar te shtëpia e të dëmtuarit Myrteza Sade dhe pasi kanë vënë në kokë kapuçat kanë kapërcyer murin rrethues dhe janë futur në oborrin e banesës private të të dëmtuarit, e cila ndodhet në rrugën "Besa" në Tiranë.

I gjykuari Florian mbante në dorë një thes, ku kishte futur automatikun e tij, një copë litar, një thikë dhe një ngjitëse, të cilat ia kishte dhënë më parë i gjykuari Arlind, ndërsa ky i fundit ishte i armatosur me një pistoletë.

Pasi kanë lënë thesin në oborr, të gjykuarit, të armatosur i janë drejtuar njëri pas tjetrit hyrjes së banesës dhe i gjykuari Arlind, pasi ka hapur derën ka hyrë në dhomën e gjumit të të dëmtuarve, ndërsa i gjykuari Florian me automatik në dorë ka qëndruar në korridor ku po flinte viktima Genci Sade.

Në momentin kur i gjykuari Arlind ka hyrë në dhomën ku flinin të dëmtuarit Myrteza dhe Hatixhe Sade, i gjykuari Florian ka dëgjuar të bërtiturat e një gruaje, prej të cilave është zgjuar viktima Genci Sade, i cili ka kapur automatikun që mbante në dorë i gjykuari Florian.

Në kohën që i gjykuari Arlind ka dalë nga dhoma e gjumit të çiftit Sade, duke u përleshur me to, i gjykuari Florian ka mbushur automatikun dhe ka qëlluar, sepse viktima Genci Sade nuk po ia lëshonte armën.

Më pas i gjykuari Florian ka dëgjuar të shtëna pistolete pranë vendit ku ishte parkuar makina e pronarëve dhe më pas ka parë viktimën Genci Sade që është rrëzuar përtokë.

Pasi kanë kapërcyer murin rrethues të banesës të gjykuarit kanë dalë në rrugë dhe janë larguar nga vendi i ngjarjes në drejtim të bregut të lumit, ku kanë hedhur armët dhe kanë djegur rrobat, në mënyrë që të fshihnin gjurmët e krimit.

Gjatë rrugës, i gjykuari Arlind, i ka treguar bashkëpunëtorit tjetër se personat me të cilët ishte përleshur i kishin hequr maskën, prandaj ai kishte qëlluar dhe në oborrin e shtëpisë i kishte mbetur njëra atlete, ndërsa i gjykuari Florian i ka treguar të gjykuarit tjetër se thesin që kishte me materiale e kishte lënë në oborrin e banesës.

Të nesërmen i gjykuari Florian ka shkuar në Elbasan te shtëpia e xhaxhait të tij ku edhe është arrestuar, ndërsa i gjykuari Arlind që nga ajo ditë i fshihet drejtësisë.

Pas kryerjes së veprimeve të para hetimore ka rezultuar se nga kjo ngjarje e rëndë ka mbetur i vdekur viktima Genci Sade, është plagosur rëndë i dëmtuari Myrteza Sade dhe është e plagosur lehtë e dëmtuara Hatixhe Sade, prandaj organi i akuzës i ka dërguar në gjyq të gjykuarit, duke i akuzuar ata për veprat penale të vjedhjes me pasojë vdekjen të kryer në bashkëpunim, vjedhjes me dhunë të kryer në bashkëpunim dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake, të parashikuara nga nenet 141-25, 139-25 dhe 278/4 të Kodit Penal.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 641, datë 2.6.2005 ka vendosur:

Deklarimin fajtor të të pandehurit Arlind Hyseni për veprën penale të vjedhjes me pasojë vdekjen e shtetasit Genci Sade, e kryer në bashkëpunim dhe, në bazë në nenit 141-25 të Kodit Penal, dënimin e tij me burgim të përjetshëm.

Ndryshimin e cilësimit ligjor të veprës penale të kryer nga i pandehuri Arlind Hyseni në dëm të shtetasit Myrteza Sade nga vjedhje me dhunë në bashkëpunim, parashikuar nga neni 139-25 i Kodit Penal në vjedhje me pasojë vdekjen e kryer në bashkëpunim dhe e mbetur në tentativë dhe, në bazë të nenit 141-25-22 të Kodit Penal, dënimin e tij me 20 vjet burgim.

Ndryshimin e cilësimit ligjor të veprës penale të kryer nga i pandehuri Arlind Hyseni në dëm të shtetases Hatixhe Sade nga vjedhje me dhunë në bashkëpunim, parashikuar nga neni 139-25 të Kodit Penal në vjedhje me pasojë vdekjen e kryer në bashkëpunim, e mbetur në tentativë dhe, në bazë të nenit 141-25-22 të Kodit Penal, dënimin e tij me 15 vjet burgim.

Deklarimin fajtor të të pandehurit Arlind Hyseni për veprën penale të mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe, në bazë të nenit 278/4 të Kodit Penal, dënimin me 10 vjet burgim.

Në bashkim të dënimeve në bazë të nenit 55 të Kodit Penal, dënimin e të pandehurit Arlind Hyseni me burgim të përjetshëm.

Si pasojë e gjykimit të shkurtuar, në zbatim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, dënimin përfundimisht të të pandehurit Arlind Hyseni me 25 vjet burgim.

Vuajtja e dënimit për të pandehurin Arlind Hyseni fillon nga dita e ekzekutimit të këtij vendimi nga policia gjyqësore.

Deklarimin fajtor të të pandehurit Florian Muça për veprën penale të vjedhjes me pasojë vdekjen e shtetasit Genci Sade, e kryer në bashkëpunim dhe, në bazë në nenit 141-25 të Kodit Penal, dënimin e tij me burgim të përjetshëm.

Ndryshimin e cilësimit ligjor të veprës penale të kryer nga i pandehuri Florian Muça në dëm të shtetasit Myrteza Sade nga vjedhje me dhunë në bashkëpunim, parashikuar nga neni 139-25 të Kodit Penal në vjedhje me pasojë vdekjen e kryer në bashkëpunim, e mbetur në tentativë dhe, në bazë të nenit 141-25-22 të Kodit Penal, dënimin e tij me 20 vjet burgim.

Ndryshimin e cilësimit ligjor të veprës penale të kryer nga i pandehuri Florian Muça në dëm të shtetases Hatixhe Sade nga vjedhje me dhunë në bashkëpunim, parashikuar nga neni 139-25 të Kodit Penal në vjedhje me pasojë vdekjen e kryer në bashkëpunim, e mbetur në tentativë dhe, në bazë të nenit 141-25-22 të Kodit Penal, dënimin e tij me 15 vjet burgim.

Deklarimin fajtor të të pandehurit Florian Muça për veprën penale të mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe, në bazë të nenit 278/4 të Kodit Penal, dënimin me 10 vjet burgim.

Në bashkim të dënimeve në bazë të nenit 55 të Kodit Penal, dënimin e të pandehurit Florian Muça

me burgim të përjetshëm.

Si pasojë e gjykimit të shkurtuar në zbatim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, dënimin përfundimisht të të pandehurit Florian Muça me 25 vjet burgim.

Vuajtja e dënimit të të pandehurit Florian Muça fillon nga dita e arrestimit në flagrancë.

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 65, datë 1.2.2006, ka vendosur:

Prishjen e vendimit nr. 641, datë 2.6.2005 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim po asaj gjykate, por me tjetër trup gjykues.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 612, datë 3.10.2007, ka vendosur:

Prishjen e vendimit nr. 65, datë 1.2.2006 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe kthimin e akteve për rishqyrtim në po atë gjykatë, por me tjetër trup gjykues.

Gjykata e Apelit Tiranë pas rigjykimit të çështjes me vendimin nr. 312, datë 16.5.2008 ka vendosur:

Lënien në fuqi të vendimit nr. 641, datë 2.6.2005 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, pasi ka marrë në shqyrtim rekursin e paraqitur nga të gjykuarit Florian Muça dhe Arlind Hyseni, me vendimin e datës 23.6.2010 ka vendosur:

Kalimin e çështjes në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë për unifikimin e praktikës gjyqësore lidhur me interpretimin e nenit 141 të Kodit Penal.

Kolegji Penal shtron për zgjidhje përpara Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë çështjet e mëposhtme:

Në rastin e akuzave për krimin e vjedhjes me pasojë vdekjen të parashikuar nga neni 141 i KP-së, kur si pasojë ka ardhur vdekja e personit, por nuk është shtënë në dorë (vjedhur) pasuria e tij, vepra penale do të konsiderohet e konsumuar apo e mbetur në tentativë?

Në rastet e akuzave për krimin e vjedhjes me pasojë vdekjen të parashikuar nga neni 141 i KP-së, kur si pasojë ka ardhur vdekja e një personi dhe plagosja (e lehtë apo e rëndë) e një apo disa personave, a kemi konkurrim me nenin 141 të KP-së të veprave të tjera vjedhje me dhunë, vjedhje me armë, plagosje e rëndë, plagosje e lehtë?

.....

Për sa i përket unifikimit të praktikës gjyqësore, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë bëjnë këtë analizë juridike:

Në nenin 141 të Kodit Penal përcaktohet se:

Vjedhja e pasurisë, kur është e shoqëruar me dhunime që kanë sjellë vdekjen e personit, dënohet me burgim nga pesëmbëdhjetë gjer në njëzet e pesë vjet, ose me burgim të përjetshëm.

Nga citimi i kësaj dispozite ligjore del qartë se Kodi Penal me anë të saj mbron në mënyrë të posaçme dy marrëdhënie të rëndësishme shoqërore, të cilat janë pasuria dhe jeta e personit, por duhet theksuar se objekti kryesor në këtë rast është pasuria, ndërsa jeta e personit është objekti dytësor, i cili është element thelbësor i veprës penale kryesore.

Kjo do të thotë se po nuk u cenua jeta e personit (po nuk erdhi vdekja e tij), atëherë nuk mund të ekzistojnë elementet e veprës penale të vjedhjes me pasojë vdekjen, parashikuar nga neni 141 i Kodit Penal, por mund të jemi përpara kryerjes së një vepre tjetër penale, siç mund të jenë vjedhja me dhunë ose vjedhja me armë, të parashikuara nga nenet 134, 139 dhe 140 të Kodit Penal.

Në Kodin Penal të vitit 1977, vepra penale objekt gjykimi ka qenë e përfshirë në veprën penale të grabitjes, e parashikuar nga neni 102 i tij, ku përfshiheshin edhe veprat penale të vjedhjes me dhunë, e parashikuar nga neni 139 i Kodit Penal dhe vjedhjes me armë, e parashikuar nga neni 140 i Kodit Penal.

Neni 102 i Kodit Penal të vitit 1977 përbëhej vetëm nga një paragraf, ku hynin përdorimi i dhunës fizike deri në vdekjen e personit, dhuna psikike dhe përdorimi i armëve, që do të thoshte se gjykata pasojën e rëndë do ta merrte vetëm si rrethanë që rëndonte masën e dënimit, e cila i caktohej subjektit të veprës penale, pasi vetë kjo dispozitë ligjore nuk e parashikonte kryerjen e veprës penale në rrethana të cilësuara.

Në Kodin Penal të vitit 1995 dhe në ndryshimet e mëpasme që i janë bërë atij, ligjvënësi e ndau veprën penale të grabitjes, të parashikuar nga neni 102 i Kodit Penal (të shfuqizuar) në tri vepra penale më vete, të cilat janë: vepra penale e vjedhjes me dhunë, e parashikuar nga neni 139 i Kodit Penal, vepra penale

e vjedhjes me armë, e parashikuar nga neni 140 i Kodit Penal dhe vepra penale e vjedhjes me pasojë vdekjen, e parashikuar nga neni 141 i Kodit Penal.

Në veprën penale të vjedhjes me dhunë, e parashikuar nga neni 139 i Kodit Penal përfshihen vjedhjet e pasurisë të shoqëruara me dhunë psikike dhe fizike (dëmtime që fillojnë nga më të lehtat e deri në më të rëndat, duke përjashtuar vdekjen), në veprën penale të vjedhjes me armë, e parashikuar nga neni 140 i Kodit Penal përfshihen vjedhjet e pasurisë të shoqëruara me përdorimin e armës me ose pa leje dhe në veprën penale të vjedhjes me pasojë vdekjen, e parashikuar nga neni 141 i Kodit Penal, përfshihen vjedhjet e pasurisë kur si rezultat i veprimeve të kundërligjshme të subjektit të veprës penale ka ardhur si pasojë vdekja e personit.

Qëllimi kryesor i ligjvënësit në shpërbërjen e veprës penale të grabitjes, të parashikuar nga neni 102 i Kodit Penal (të shfuqizuar), ka qenë fakti që kjo dispozitë ligjore nuk parashikonte rastet kur vepra penale kryhej në rrethana të cilësuara dhe kishte një ndryshim shumë të madh ndërmjet minimumit dhe maksimumit të masës së dënimit, çka në disa raste ka lejuar qëndrime jo të drejta në caktimin e masave të dënimeve.

Doktrina jonë juridike dhe praktika gjyqësore shumëvjeçare kanë mbajtur qëndrimin e konsoliduar se grabitja, e parashikuar nga neni 102 i Kodit Penal (të shfuqizuar), quhet krim i kryer nga çasti i kryerjes së sulmit, pavarësisht nëse autori i krimit ka arritur ose jo të hedhë në dorë pasurinë. Kjo shpjegohet nga fakti se ligjvënësi për shkak të rrezikshmërisë së theksuar të veprës penale i jepte rëndësi vendimtare jo kalimit të pasurisë, por sulmit për të vënë në dorë pasurinë. Nuk kishte rëndësi nëse dhuna përdorej para hedhjes në dorë të pasurisë ose gjatë përpjekjeve për t'u larguar të subjektit të veprës penale.

Aktualisht ka qëndrime të ndryshme në praktikë në lidhje me faktin se nëse vepra penale e vjedhjes me pasojë vdekjen, e parashikuar nga neni 141 i Kodit Penal, mbetet ose jo në fazën e tentativës, kur subjekti i veprës penale me gjithë veprimet e kryera prej tij për ta realizuar veprën penale nuk ka arritur për shkaqe që nuk vareshin prej tij për të shtënë në dorë pasurinë, por si pasojë e veprimeve të kundërligjshme të tij ka ardhur pasoja e rëndë, që është vdekja e personit, i cili ishte vënë në mbrojtje të pasurisë.

Për të krijuar një tablo më të qartë se çfarë përfaqëson në vetvete vepra penale e vjedhjes me pasojë vdekjen, e parashikuar nga neni 141 i Kodit Penal, është e domosdoshme që t'i referohemi doktrinës juridike në vite, e cila e ka përkufizuar atë si një vepër penale të përbërë nga dy vepra penale, që janë vepra penale e vjedhjes dhe vepra penale e vrasjes së personit, të cilat në kushtet e zakonshme qëndrojnë si vepra penale më vete, e para e parashikuar nga neni 134 e vijues i Kodit Penal dhe tjetra e parashikuar nga neni 76 e vijues i Kodit Penal.

Megjithëse në Kodin Penal veprat penale të vjedhjes dhe të vrasjes së personit parashikohen si vepra penale më vete, në rastin e nenit 141 të Kodit Penal vepra penale e vrasjes së personit është element thelbësor i veprës penale të vjedhjes, e cila kurrsesi nuk mund të kryhet nëse nuk vjen pasoja shumë e rëndë, që është vdekja e personit.

Figura e veprës penale të vjedhjes me pasojë vdekjen, e parashikuar nga neni 141 i Kodit Penal përbëhet nga dy vepra penale materiale, për të cilat është e detyrueshme ardhja e pasojës kur ato qëndrojë si vepra penale më vete, në mënyrë që ato të quhen të konsumuara plotësisht, ndërsa në rastin kur ato janë të lidhura me njëra-tjetrën sipas nenit 141 të Kodit Penal dhe kur nga kryerja e veprës penale, e cila është element thelbësor i veprës tjetër penale pasoja e rëndë vjen detyrimisht, atëherë nuk mund të thuhet që vepra penale kryesore ka mbetur në fazën e tentativës, në një kohë kur personi që po mbronte pasurinë nuk jeton më, pasi kjo logjikë juridike nuk do të funksiononte.

Në ndryshim nga vepra penale e vjedhjes me armë, e parashikuar nga neni 140 i Kodit Penal dhe vepra penale e vjedhjes me dhunë, e parashikuar nga neni 139 i Kodit Penal te të cilat vepra penale që i përket objektit dytësor mund të jetë një vepër penale formale, e cila nuk kërkon ardhjen e pasojës, siç janë mbajtja e armës ose dhuna psikike, vepra penale e vjedhjes me pasojë vdekjen e kërkon detyrimisht ardhjen e pasojës së rëndë për veprën penale që shërben si element thelbësor për veprën tjetër penale, që do të thotë se po nuk erdhi vdekja e personit, vepra penale e vjedhjes me pasojë vdekjen nuk do të kryhej dhe nuk kishte asnjë arsye që ajo të parashikohej si vepër penale në pjesën e posaçme të Kodit Penal, prandaj pasoja e rëndë e veprës penale që i përket objektit dytësor është pasojë e rëndë edhe për veprën penale që i përket objektit kryesor dhe rrjedhimisht vepra penale e vjedhjes me pasojë vdekjen është e konsumuar plotësisht

që në momentin që ka ardhur pasoja e rëndë vdekja e personit, pavarësisht nëse subjekti i veprës penale e ka shtënë ose jo në dorë pasurinë.

Nga leximi i nenit 141 të Kodit Penal del mjaft e qartë se vetë kjo dispozitë ligjore e konsideron këtë vepër penale automatikisht të konsumuar, sepse përdor shprehjen *... shoqëruar me dhunime që kanë sjellë si pasojë vdekjen e personit ...,* ndryshe nga vepra penale kryesore e vjedhjes së pasurisë (kur është më vete), parashikuar nga neni 134 i Kodit Penal, në të cilin përdoret shprehja se: *vjedhja e pasurisë dënohet ...,* gjykata vlerëson se kjo e fundit mund të mbetet në fazën e tentativës, pasi ligji nuk kërkon medoemos ardhjen e pasojës.

Pavarësisht vendosjes së veprës penale të vjedhjes me pasojë vdekjen, e parashikuar nga neni 141 i Kodit Penal në kreun III të Kodit Penal ku parashikohen veprat penale kundër pasurisë dhe sferës ekonomike, ligjvënësi i ka dhënë një rëndësi shumë të madhe mbrojtjes dhe paprekshmërisë së jetës së personit, pavarësisht se kjo pasojë në këtë rast vjen si rrjedhojë e kryerjes së veprës penale dytësore, e cila shërben si element thelbësor për veprën penale kryesore.

Një çështje tjetër që ka qenë objekt diskutimi në Kolegjet e Bashkuara ka qenë fakti nëse vepra penale e vjedhjes me pasojë vdekjen, e parashikuar nga neni 141 i Kodit Penal konkurron me veprat penale të vjedhjes me dhunë, vjedhjes me armë, plagosjes së rëndë dhe plagosjes së lehtë, të parashikuara nga nenet 139, 140, 88 e 89 të Kodit Penal.

Teoria e së drejtës penale dhe praktika jonë gjyqësore në vite kanë konsoliduar qëndrimin se veprat penale konkurrojnë me njëra-tjetrën, atëherë kur ato qëndrojnë si vepra penale më vete, por nëse njëra prej tyre shërben si element thelbësor për veprën tjetër penale, atëherë nuk kemi konkurrim të tyre.

Vepra penale e vjedhjes me dhunë, e parashikuar nga neni 139 i Kodit Penal dhe vepra penale e vjedhjes me armë, e parashikuar nga neni 140 i Kodit Penal kur kryhen për shtënien në dorë të së njëjtës pasuri në asnjë rrethanë nuk mund të konkurrojnë me veprën penale të vjedhjes me pasojë vdekjen, e parashikuar nga neni 141 i Kodit Penal, sepse edhe kjo e fundit është një formë e cilësuar e dy të parave, pasi edhe në këtë rast nga ana objektive vepra penale kryhet me dhunë, e cila është ekstreme dhe përfundon me vdekjen e personit.

Gjithashtu, gjatë kryerjes së veprës penale të vjedhjes me pasojë vdekjen, e parashikuar nga neni 141 i Kodit Penal, subjekti i veprës penale nga ana objektive mund ta përdorë armën, ashtu, si dhe nga kryerja e veprës penale të vjedhjes me armë, e parashikuar nga neni 140 i Kodit Penal mund të vijë pasoja e rëndë (dëmtimet fizike, deri te plagosja e rëndë), por ajo që i dallon këto dy vepra penale nga njëra-tjetra është fakti se te vjedhja me pasojë vdekjen, e parashikuar nga neni 141 i Kodit Penal, domosdoshmërish duhet të kemi një ose më shumë viktima, prandaj nëse konstatohet ardhja e kësaj pasoje, atëherë pavarësisht se gjatë vjedhjes mund të përdoret arma, ose mund të ketë dhunë psikike edhe dëmtime në formën e lezioneve, nuk do të kemi konkurrim të veprave penale, pasi dy veprat penale më të lehta nuk mund të qëndrojnë si vepra penale më vete, por i thith vepra penale më e rëndë, e parashikuar nga neni 141 i Kodit Penal.

Vepra penale e vjedhjes me pasojë vdekjen, e parashikuar nga neni 141 i Kodit Penal nuk konkurron as me plagosjen e rëndë, ose të lehtë, të parashikuara nga nenet 88 dhe 89 të Kodit Penal, kur këto dëmtime kryhen në funksion të shtënies në dorë të së njëjtës pasuri, ose të largimit të pengesave që nuk e lejojnë subjektin e veprës penale që të largohet menjëherë nga vendngjarja.

Nëse subjekti i veprës penale ka kryer një plagosje të rëndë apo të lehtë para ose pas kryerjes së veprës penale të vjedhjes me pasojë vdekjen, por që nuk kanë lidhje me këtë të fundit, atëherë veprat penale të plagosjes së rëndë ose të lehtë qëndrojnë si vepra penale më vete dhe për rrjedhojë do të ishim para institutit të konkurrimit të veprave penale.

Duhet të kemi parasysh se në këtë rast dallimin e bën ana subjektive si një nga elementet e veprës penale, që do të thotë se nëse subjekti i veprës penale e bën plagosjen e rëndë ose të lehtë të personit në funksion të shtënies në dorë të së njëjtës pasuri, ose të mbrojtjes së saj menjëherë pas vjedhjes, atëherë nuk do të jemi përpara konkurrimit të veprave penale, pasi dhuna e bërë në këtë rast është një pasojë, e cila përfshihet në veprën penale të vjedhjes me pasojë vdekjen, ku krahas vdekjes së një personi mund të kemi si pasojë edhe dëmtimin e personave të tjerë.

Vepra penale e vjedhjes me pasojë vdekjen, kur është rrjedhojë e një mendimi unik kriminal, i cili ka si qëllim vjedhjen e të njëjtës pasuri, duhet të cilësohet vetëm një herë sipas nenit 141 të Kodit Penal, pavarësisht nga numri i pasojave të rënda që kanë ardhur, siç mund të jenë vdekja e dy ose më shumë personave, vdekja e një personi dhe plagosja e një ose më shumë të tjerëve dhe faktin që ka pasur më tepër se një pasojë të rëndë, gjykata duhet ta mbajë parasysh në caktimin e masës së dënimit.

Në mendimin e tij, të dhënë përpara Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, prokurori kërkoi që i gjykuari Arlind Hyseni të deklarohet fajtor e dënohet për veprën penale të vrasjes në rrethana cilësuese, e parashikuar nga neni 79/ë i Kodit Penal, ndërsa i gjykuari tjetër të deklarohet fajtor e dënohet për veprën penale të vjedhjes me pasojë vdekjen, e kryer në bashkëpunim dhe e mbetur në tentativë, parashikuar nga neni 141-22-25 i Kodit Penal, për sa i përket viktimës Genci Sade, në një kohë që nga gjykimet ka rezultuar e provuar se ata në bashkëpunim me njëri-tjetrin kanë qenë ekzekutorë të veprës penale të vjedhjes me pasojë vdekjen e shtetasit Genci Sade, e parashikuar nga neni 141-25 i Kodit Penal.

Megjithëse mendimi i prokurorit nuk referon në ndonjë dispozitë ligjore konkrete, të parashikuar nga legjislacioni ynë procedural dhe material penal, kërkesa e tij është në kundërshtim me nenin 116 të Kushtetutës, pasi ai i referohet një legjislacioni dhe praktike të huaj gjyqësore, të cilat nuk janë pjesë e së drejtës tonë penale, prandaj, sipas dispozitës kushtetuese që përmendëm më lart, ato nuk mund të gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjes konkrete.

Nëse shihet me kujdes mendimi i prokurorit del qartë se, duke i copëtuar akuzat sipas pasojave të ardhura në të vërtetë ai nuk kërkon një cilësim të ndryshëm ligjor të veprave penale, por ngre akuza të reja në ngarkim të të gjykuarve, gjë e cila nuk mund të bëhet në këtë fazë të gjykimit, pasi ndryshimi i cilësimit juridik të veprave penale duhet t'u nënshtrohet rigorozisht përcaktimeve të bëra nga neni 375 i Kodit të Procedurës Penale.

Duke arsyetuar si më sipër, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arrijnë në këto përfundime unifikuese:

- Vepra penale e vjedhjes me pasojë vdekjen, e parashikuar nga neni 141 i Kodit Penal, kur si pasojë ka ardhur vdekja e personit, por nuk është shtënë në dorë (vjedhur) pasuria e tij, do të konsiderohet plotësisht e konsumuar që nga çasti që ka ardhur si pasojë vdekja e personit, të cilit i përkiste pasuria ose ishte vënë në mbrojtje të saj, pavarësisht nga shtënia në dorë ose jo e kësaj pasurie nga subjekti i veprës penale.

- Vepra penale e vjedhjes me pasojë vdekjen, e parashikuar nga neni 141 i Kodit Penal, kur si pasojë ka ardhur vdekja e një personi dhe plagosja (e lehtë apo e rëndë) e një apo disa personave, nuk konkurron me veprat penale të vjedhjes me dhunë, vjedhjes me armë, plagosjes së rëndë dhe plagosjes së lehtë, të parashikuara nga nenet 139, 140, 88 dhe 89 të Kodit Penal, gjithmonë kur bëhet fjalë që këto të fundit janë kryer në funksion të shtënies në dorë të së njëjtës pasuri.

.....

Për sa i përket zgjidhjes së çështjes konkrete, Kolegjet e Bashkuara bëjnë këtë analizë juridike:

Në rekurs i gjykuari Florian Muça pretendon se megjithëse Gjykata e Shkallës së Parë bëri ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale, për sa u përket të dëmtuarve Myrteza dhe Hatixhe Sade, përsëri ajo gaboi, sepse veprimet e të gjykuarve janë rrjedhojë e një mendimi unik kriminal, prandaj cilësimi juridik i veprës penale duhej të bëhej vetëm një herë sipas nenit 141-25 të Kodit Penal, pretendim i cili vlerësohet si i bazuar në ligj, pasi të gjykuarit Arlind Hyseni dhe Florian Muça në marrëveshje të mëparshme me njëri-tjetrin kanë vendosur që me çdo mjet të vjedhin banesën e shtetasit Myrteza Sade, por meqenëse ata hasën në kundërshtimin e fortë të tre anëtarëve të familjes, për t'i shpëtuar përgjegjësisë penale vranë viktimën Genci Sade dhe plagosën të dëmtuarit Myrteza e Hatixhe Sade.

Veprimet e të gjykuarve ashtu siç pretendon edhe mbrojtja e të gjykuarit Florian janë rrjedhojë e një mendimi unik kriminal, prandaj vepra penale nuk duhet të cilësohet sipas pasojave të ardhura, por ajo duhet të cilësohet vetëm një herë si vepër penale e vjedhjes me pasojë vdekjen, e kryer në bashkëpunim, e parashikuar nga neni 141-25 i Kodit Penal.

Vepra penale e vjedhjes me pasojë vdekjen, e kryer në bashkëpunim, e parashikuar nga neni 141-

25 të Kodit Penal është e konsumuar plotësisht, sepse është e provuar se nga veprimet e paligjshme të të gjykuarve ka ardhur pasoja e rëndë e vdekjes së shtetasit Genci Sade dhe për rrjedhojë nuk ka vend që të pranohet kërkesa e të gjykuarve për cilësimin e kësaj vepre penale, si vepër penale e mbetur në fazën e tentativës.

Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se edhe për veprën penale të mbajtjes pa leje të armëve luftarake, për të cilën akuzohen dy të gjykuarit, ka vend për ndryshimin e cilësimit juridik, në përputhje me nenin 375 të Kodit të Procedurës Penale, pasi kjo vepër penale nuk është kryer në sasira të mëdha dhe në bashkëpunim nga të gjykuarit, pasi ato kanë qenë të armatosur me armë personale pa leje, përpara se të shkonin në vendngjarje. Gjithashtu, nuk është e provuar se të gjykuarit e kanë kryer më shumë se një herë këtë vepër penale dhe pasoja e rëndë që parashikon neni 278/4 i Kodit Penal nuk ka kuptimin e një vrasjeje apo dëmtimeve të tjera, por ajo ka kuptimin e pasojave të rënda që mund të vijnë si rezultat i shpërthimeve, ose i burimit të rrezikut të shtuar, prandaj vepra penale e mbajtjes pa leje të armëve luftarake, e kryer nga të gjykuarit duhet të cilësohet sipas nenit 278/2 të Kodit Penal.

Duhet theksuar se vepra penale e mbajtjes pa leje të armëve luftarake, e parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal, konkurron me veprën penale të vjedhjes me pasojë vdekjen, pasi në këtë të fundit vrasja e personit mund të bëhet edhe me mjete të tjera, si: litar, të cilin të gjykuarit e kishin marrë me vete, sende të forta etj., prandaj vepra penale e mbajtjes pa leje të armëve luftarake nuk është element thelbësor i veprës penale të vjedhjes me pasojë vdekjen, parashikuar nga neni 141 i Kodit Penal (shih vendimin unifikues nr. 1, datë 3.2.2006 të Kolegjeve të Bashkuara).

Pretendimet e tjera të ngritura në rekurs nga të gjykuarit janë të pabazuara në ligj, sepse nuk mund të jemi përpara eksesit të ekzekutorit siç pretendon i gjykuari Florian Muça, sepse ky i fundit në çdo vend ka qenë bashkë me të gjykuarin tjetër, ka qenë i armatosur më rëndë se ai, ka qëlluar mbi të dëmtuarit, pasi në vendngjarje janë sekuestruar gëzhojat e dy armëve të ndryshme, ka shkuar bashkë me bashkëpunëtorin tjetër për të fshehur armët etj. Eksesi i ekzekutorit kërkon që bashkëpunëtorët të mos jenë marrë vesh për atë që kryen njëri prej tyre dhe ai që pretendon eksesin nuk duhet të ketë marrë pjesë në kryerjen e atij veprimi të kundërligjshëm.

Masat e dënimit të të gjykuarve janë caktuar nga gjykata në përputhje të plotë me kërkesat e nenit 47 të Kodit Penal, duke u pasur parasysh rrethanat e parashikuara nga nenet 48, 49 dhe 50 të Kodit Penal, sepse duhet theksuar se në ngarkim të të gjykuarve ka rrethana rënduese të parashikuara nga germat **"gj"** dhe **"i"** të nenit 50 të Kodit Penal, prandaj pretendimi i të gjykuarit Florian për të pasur diferencime në masën e dënimit me të gjykuarin tjetër në mungesë është i pabazuar në ligj, pasi ai ashtu, si dhe bashkëpunëtori i tij kanë pasur të njëjtin rol në kryerjen e veprës penale atë të ekzekutorit, çka tregon që ai është një person me rrezikshmëri të theksuar shoqërore.

Si përfundim, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë se, mbështetur në analizën mbi zbatimin e ligjit dhe përfundimet unifikuese të lartpërmendura, pretendimet e parashtruara në rekursin e të gjykuarve Arlind Hyseni dhe Florian Muça janë pjesërisht të bazuara në ligj, prandaj vendimet e gjykatave duhet të ndryshohen, vetëm për sa i përket cilësimit juridik të veprave penale.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në mbështetje të neneve 438 dhe 441/b të Kodit të Procedurës Penale,

VENDOSËN:

Ndryshimin e vendimit nr. 312, datë 16.5.2008 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe vendimit nr. 641, datë 2.6.2005 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Deklarimin fajtor të të pandehurit Arlind Hyseni për veprën penale të vjedhjes me pasojë vdekjen e kryer në bashkëpunim dhe, në bazë të nenit 141 e 25 të Kodit Penal, dënimin e tij me burgim të përjetshëm.

Deklarimin fajtor të të pandehurit Arlind Hyseni për veprën penale të mbajtjes pa leje të armëve

luftarake dhe, në bazë të nenit 278/2 të Kodit Penal, dënimin e tij me 3 vjet burgim.

Në bashkim të dënimeve, në zbatim të nenit 55 të Kodit Penal, dënimin e të pandehurit Arlind Hyseni me burgim të përjetshëm.

Në zbatim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale dënimin përfundimtar të të pandehurit Arlind Hyseni me 25 (njëzet e pesë) vjet burgim.

Vuajtja e dënimit për këtë të pandehur fillon nga dita e ekzekutimit të këtij vendimi.

Deklarimin fajtor të të pandehurit Florian Muça për veprën penale të vjedhjes me pasojë vdekjen e kryer në bashkëpunim dhe, në bazë të nenit 141 e 25 të Kodit Penal, dënimin e tij me burgim të përjetshëm.

Deklarimin fajtor të të pandehurit Florian Muça për veprën penale të mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe, në bazë të nenit 278/2 të Kodit Penal, dënimin e tij me 3 vjet burgim.

Në bashkim të dënimeve, në zbatim të nenit 55 të Kodit Penal, dënimin e të pandehurit Florian Muça me burgim të përjetshëm.

Në zbatim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale dënimin përfundimtar të të pandehurit Florian Muça me 25 (njëzet e pesë) vjet burgim.

Vuajtja e dënimit për këtë të pandehur fillon nga dita e arrestimit të tij në flagrancë, në datën 13.7.2004.

Ky vendim është unifikues dhe dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Shpresa Beçaj (kryesuese), Ardian Dvorani, Ardian Nuni, Guxim Zenelaj, Evelina Qirjako, Arjana Fullani, Aleksandër Muskaj, Medi Bici

Anëtarë kundër: Gani Dizdari, Besnik Imeraj (pjesërisht kundër), Fatos Lulo, Majlinda Andrea, Andi Çeliku (pjesërisht kundër), Mirela Fana

MENDIMI I PAKICËS

Për vendimin nr. 6, datë 30.9.2011 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë

Ne gjyqtarët Besnik Imeraj, Gani Dizdari, Majlinda Andrea, Fatos Lulo, Mirela Fana nuk jemi dakord me vendimin e marrë nga shumica, e cila ka ndryshuar vendimet e Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë dhe Gjykatës së Apelit Tiranë, duke deklaruar fajtorë dhe dënuar të gjykuarit për veprën penale të vjedhjes me pasojë vdekjen.

Ndryshe nga vendimi i shumicës, me të cilin është vendosur ndryshimi i dy vendimeve të gjykatave të faktit, duke i deklaruar fajtorë dhe dënuar të gjykuarit për veprën penale të vjedhjes me pasojë vdekjen e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 141 e 25 i Kodit Penal, jemi të mendimit se si vendimi nr. 312, datë 16.5.2008 i Gjykatës së Apelit Tiranë edhe vendimi nr. 461, datë 2.6.2005 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë duheshin prishur në lidhje me cilësimin juridik të veprës penale, duke i deklaruar fajtorë të gjykuarit për veprën penale të vjedhjes me pasojë vdekjen e kryer në bashkëpunim e mbetur në tentativë, në lidhje me vdekjen e shtetasit Genci Sade; ndërsa në lidhje me plagosjen me armë zjarri në vendngjarje të shtetasve Myrteza e Hatixhe Sade, të gjykuarit duhet të deklaroheshin fajtorë për kryerjen e veprës penale të vjedhjes me armë në bashkëpunim, parashikuar nga neni 140 e 25 të Kodit Penal.

Duke mos dashur të përsërisim me detaje rrethanat e çështjes, të cilat janë trajtuar në vendimin e shumicës, do të argumentojmë më poshtë qëndrimin tonë kundër, mbështetur në dispozitat ligjore.

Shumica pasi ka parashtruar sintetikisht faktet e administruara nga gjykatat e dy niveleve, ka arritur në përfundimin se vendimet duheshin ndryshuar në lidhje me cilësimin juridik të veprës.

Ka rezultuar e provuar se të gjykuarit Arlind Hyseni e Florian Muça, të pajisur edhe me armë zjarri, litar, kapuça për maskim, thikë e letër ngjitëse, kanë bërë plan dhe kanë shkuar për të vjedhur në banesën e shtetasit Myrteza Muça, me qëllim për të vjedhur. I pandehuri Arlind ka hyrë në dhomën ku flinin çifti Myrteza e Hatixhe Sade (prindërit e viktimës Genci Sade). Gjatë përleshjes me çiftin, që është zgjuar, është zgjuar edhe djali i tyre Genci, i cili ka dashur t'i marrë armën të pandehurit Florian Muça, por ky i fundit ka mbushur automatikun dhe ka qëlluar e më pas kur ka nisur të largohet ka dëgjuar krisma pistolete dhe ka parë viktimën Genci që është rrëzuar në tokë. Për shkak të rrjedhës së mësipërme të ngjarjes, të

pandehurit janë larguar, pasi kanë kapërcyer murin rrethues të shtëpisë dhe kanë dhe gjatë bregut të lumit kanë hedhur armët dhe kanë djegur rrobat, duke mos mundur të realizojnë këtë vjedhje. Gjatë tentativës për kryerjen e vjedhjes, nga ana e të gjykuarit Arben Nika është vrarë me armë zjarri i ndjeri Genci Sade dhe është plagosur rëndë shtetasi Myrteza Sade dhe plagosur lehtë shtetasja Hatixhe Sade.

Duke arsyetuar se të gjykuarit kanë konsumuar veprën penale të vjedhjes me pasojë vdekjen për viktimën Genci Sade, Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë ka konkluduar se ajo është konsumuar, ndërsa ajo (vepra) ka mbetur në tentativë për sa u përket të dëmtuarve Myrteza e Hatixhe Sade. Vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë është lënë në fuqi me të njëjtin arsyetim nga gjykata e apelit.

Ne gjyqtarët në pakicë, ndryshe nga vendimi i shumicës, mendojmë se cilësimi ligjor i veprës penale në ngarkim të të gjykuarve, lidhur me vrasjen e shtetasit Genci Sade gjatë tentativës për vjedhjen e banesës së familjes Sade, duhet të kualifikohej si e mbetur në tentativë.

Edhe pakica është dakord me qëndrimin se, me anë të dispozitës së nenit 141 të Kodit Penal, mbrohen dy marrëdhënie të rëndësishme shoqërore, siç janë pasuria dhe jeta e personit, duke mbajtur parasysh se objekti kryesor në këtë rast është pasuria, ndërsa jeta e personit është objekti dytësor, por pakica nuk ka të njëjtin qëndrim me shumicën se objekti i dytë i kësaj vepre penale është dhe elementi thelbësor i saj. Në Kodin Penal të vitit 1995, nuk është parashikuar si vepër penale ajo e grabitjes, por ekzistojnë tri vepra penale të ndryshme, parashikuar nga nenet 139, 140, 141, të cilat kanë për objekt marrëdhëniet juridike të vendosura për të siguruar paprekshmërinë e pasurisë së personit fizik, personit juridik dhe shtetit dhe jetën e personit, por ne pakica nuk jemi të të njëjtit mendim se pasoja në veprën penale të vjedhjes me dhunë e bën këtë vepër të cilësuar.

Vepra penale e parashikuar nga neni 141 i Kodit Penal, bën pjesë në seksionin e parë të titulluar "vjedhja e pasurisë" të kreut III të Kodit Penal, kre në të cilin janë përfshirë veprat penale kundër pasurisë dhe në sferën e ekonomisë. Objekti kryesor i kategorisë së veprave penale që përfshihen në këtë seksion janë marrëdhëniet juridike të vendosura për të siguruar paprekshmërinë e pasurisë së personit, e mbrojtur kjo posaçërisht nga legjislacioni penal, por në disa prej këtyre veprave, marrëdhëniet juridike që preken janë më shumë se një. Kështu, në rastin e dispozitës së nenit 141 të Kodit Penal, veç marrëdhënieve të vendosura për mbrojtjen e pasurisë së personit, autori prek direkt edhe ato marrëdhënie juridike të vendosura për të siguruar të drejtën e një personi për të jetuar, e sanksionuar kjo nga neni 21 i Kushtetutës. Edhe pse prekja e këtij objekti nga vepra penale paraqet rrezikshmëri shumë më të madhe shoqërore se ai që mbron paprekshmërinë e pronës.

Pakica çmon se vepra do të cilësohet e kryer atëherë kur autori ka cenuar të dyja marrëdhëniet juridike që mbron kjo dispozitë. Nuk mund të cilësohet vjedhja e pasurisë së tjetrit e kryer kur provohet se autori nuk ka mundur të realizojë deri në fund qëllimin e tij, pra pakësimin e pasurisë së tjetrit. Në rrethana të tilla, ndërkohë që vjedhja e pasurisë ka mbetur në fazën e tentativës, pasoja tjetër që kërkon dispozita e nenit 141 të Kodit Penal është konsumuar, pra është vërtetuar vdekja e viktimës Genci Sade. Fakti që me veprimet e tyre të gjykuarit Arlind Hyseni e Florian Muça nuk kanë mundur të realizojnë vjedhjen, vepra penale për të cilën ata duhet të deklarohen fajtorë, ka mbetur në fazën e tentativës.

Neni 22 i Kodit Penal parashikon se: "Vepra penale quhet e mbetur në tentativë kur, megjithëse personi ndërmerr veprime të drejtpërdrejta për ta kryer atë, vepra ndërpritet e nuk përfundohet për rrethana të pavarura nga vullneti i tij". Në kuptim të kësaj dispozite, të gjykuarit për shkaqe të pavarura nga vullneti i tyre, megjithëse kanë ndërmarrë veprime të drejtpërdrejta për të vjedhur banesën e familjes Sade, nuk kanë mundur të realizojnë qëllimin, duke mos mundur të vjedhin, për shkak se nuk u lejuan prej viktimave. Është e vërtetë se gjatë tentativës për të realizuar vjedhjen të gjykuarit, për të shmangur pengesat, kanë vrarë një person (të ndjerin Genci Sade), por ky fakt nuk mund ta cilësojë vjedhjen si të kryer, ndërkohë që provohet të mos ketë pasur pakësim të pasurisë.

Gjithashtu, ne gjyqtarët në pakicë, kemi mendim të kundërt me shumicën edhe për sa i përket konkluzionit lidhur me çështjen e dytë shtruar për zgjidhje në Kolegjet e Bashkuara, lidhur me konkurrimin e veprave penale të parashikuar nga neni 141, me veprat penale të parashikuara nga nenet 139, 140, 88 dhe 89 të Kodit Penal, për të cilën Kolegjet e Bashkuara kanë arritur në konkluzionin unifikues se: "Vepra penale e vjedhjes me pasojë vdekjen, e parashikuar nga neni 141 i Kodit Penal, kur si pasojë ka ardhur vdekja e një personi dhe plagosja (e lehtë apo e rëndë) e një apo disa personave, nuk konkurron me veprat

penale të vjedhjes me dhunë, vjedhjes me armë, plagosjes së rëndë, plagosjes së lehtë, të parashikuara nga nenet 139, 140, 88 dhe 89 të Kodit Penal, gjithmonë kur bëhet fjalë që këto të fundit janë kryer në funksion të shtënies në dorë të së njëjtës pasuri".

Ndryshe nga shumica, ne gjyqtarët në pakicë kemi mendimin se vepra penale e vjedhjes me pasojë vdekjen, konkurron me veprat penale të vjedhjes me dhunë dhe vjedhjes me armë, në rastin kur gjatë përpjekjes për vjedhjen e pasurisë, krahas pasojës së vdekjes së një personi, vijnë edhe pasoja të tjera, pra dëmtime të një apo disa personave të tjerë.

Edhe pse ashtu siç ka pranuar shumica ardhja e pasojave të tjera gjatë tentativës për vjedhjen e pasurisë janë pasoja të ardhura gjatë një veprimi unik kriminal, mendojmë që përveç vdekjes së një personi, pasojë pa të cilin nuk mund të ekzistonte kjo vepër penale, pasojat e tjera nga vepra penale, e cila ka pasur si qëllim pakësimin e pasurisë, siç janë plagosje e lehtë apo e rëndë, nuk mund që të përfshihen në veprën penale të vjedhjes me pasojë vdekjen, pasi për personat e tjerë pasoja e veprimeve kriminale të autorit janë të tjera.

Pakica mendon se vepra penale e vjedhjes me pasojë vdekjen konkurron me veprat penale të vjedhjes me dhunë dhe vjedhjes me armë dhe jo me plagosjen e rëndë me dashje dhe plagosjen e lehtë me dashje të parashikuara nga nenet 88 e 89 të Kodit Penal, pasi këto të fundit, pra dëmtimet e personave të tjerë që përpiqen të ruajnë pasurinë apo zmbrapsin veprimet e autorit, vijnë si rezultat i veprimeve kriminale të autorit për të bërë të mundur arritjen e qëllimit, vjedhjes së pasurisë dhe në analizë të elementeve të veprës penale, këto pasoja përfshihen në anën objektive të veprave penale të vjedhjes me dhunë dhe vjedhjes me armë (nëse autori përdor armë).

Përfundimisht mendojmë se vendimi i gjykatës së apelit duhet të prishej dhe të gjykuarit Arlind Hyseni e Florian Muça të deklaroheshin fajtorë për kryerjen e veprës penale të vjedhjes me pasojë vdekjen të kryer në bashkëpunim e të mbetur në tentativë në dëm të shtetasit Genci Sade, parashikuar nga neni 141-25-22 të Kodit Penal dhe të deklaroheshin fajtorë për veprën penale të vjedhjes me armë të kryer në bashkëpunim, në dëm të shtetasve Myrteza e Hatixhe Sade, parashikuar nga neni 140 e 25 i Kodit Penal.

Anëtarë: Majlinda Andrea, Besnik Imeraj, Gani Dizdari, Fatos Lulo, Mirela Fana